



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

MINISTRI

Nr. 6290 Prot.

Tiranë, më 20.9.2016

URDHËR

Nr. 182, datë 20.9 2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES

“PËR TRAJTIMIN E LLOJEVE TË FAUNËS SË EGËR NË ZOOPARQE DHE NË  
MJEDISE TË TJERA, KU INDIVIDËT I EKSPOZOHEN PUBLIKUT”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës "d" të nenit 28 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe në zbatim të nenit 26 pika 2 të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për trajtimin e individëve të llojeve të faunës së egër në zooparqe apo në mjedise të tjera, ku individët i ekspozohen publikut”, sipas draftit që i bashkëlidhet këtij urdhëri, si pjesë përbërëse e tij.
2. Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura dhe Drejtoria Juridike, e Komunikimit dhe Prokurimeve të dërgojnë urdhërin për botim pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, brenda 2 ditëve nga miratimi i tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



Lefter KOKA

MINISTËR